



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 22.1.1-2017-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË
MITROVICËS
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017

Prishtinë, maj 2018

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Mitrovicës, në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Udhëheqës Ekipi, Igballe Halili dhe Anëtarëve, Abdurrahmon Berbatovci dhe Arnisa Aliu, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Zukë Zuka.

TABELA E PËRMBAJTJES

| | |
|--|----|
| Përmbledhje e përgjithshme | 4 |
| 1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit | 6 |
| 2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm | 7 |
| 3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli | 12 |
| 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve..... | 25 |
| 5 Qeverisja e mirë..... | 26 |
| Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA | 29 |
| Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake..... | 31 |
| Shtojca III: Letër konfirmimi | 43 |

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Komunës së Mitrovicës për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 04/10/2017.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i komunës.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson Menaxhmentin e lartë dhe stafin e komunës për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjës

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Theksim i Çështjës

Si theksim të çështjes, duam të përmendim faktin se:

- Komuna kishte paguar gabimisht mallra dhe shërbime në vlerë 182,010€, nga kategoria e investimeve kapitale, si dhe subvencione në vlerë 18,996€, nga mallrat dhe shërbimet;
- Ndonëse është shënuar progres në evidentimin e disa pronave, komuna ende nuk ka arritur t'i regjistrojë të gjitha tokat dhe objektet në regjistrin e pasurisë; dhe
- Detyrimet kontingjente nuk ishin prezantuar saktë, pasi që disa padi ndaj komunës nuk janë raportuar në pasqyrat financiare.

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore

Procesi i përgatitjes së PFV-ve është menaxhuar në përgjithësi sipas kërkesave ligjore. Çështjet e theksuara në opinionin e auditimit ishin për shkak se klasifikimi i disa shpenzimeve nuk ishte në kategori adekuat si dhe pasuritë dhe detyrimet kontingjente nuk janë prezantuar saktë.



Kryetari duhet të sigurohet se procesi i përgatitjes së pasqyrave financiare për vitin 2018 përfshinë një rishikim përfundimtar të menaxhmentit përgjegjës, dhe deklarata për PFV-të të nënshkruhet vetëm pasi të jenë zbatuar të gjitha veprimet e nevojshme (shih nënkapitullin 2.1).

Kontrollet e brendshme në disa sisteme të rëndësishme financiare duhet të shtohen, duke përfshirë shpenzimet, të hyrat, si dhe në menaxhmin e llogarive të arkëtueshme dhe të obligimeve.



Kryetari duhet ta aplikojë një vlerësim të detajuar të fushave brengosëse të theksuara në këtë raportë për t'i identifikuar arsyet për paraqitjen e dobësive si dhe veprimet e nevojshme për t'i adresuar ato (shih çështjet 2 -14).

Përkundër veprimeve për hartimin e planit të veprimit, rekomandimet kyçe nuk po adresohen ashtu siç kërkohet për zhvillimin e komunës.



Kryetari duhet ta zbatojë një proces rigoroz për të siguruar që rekomandimet e viteve paraprake zbatohen në mënyrë aktive dhe progresi t'i raportohet menaxhmentit në baza mujore (shih çështjen 15).

Aranzhimet e qeverisjes që kanë të bëjnë me menaxhimin e rrezikut dhe raportimin menaxherial duhet të përmirësohen. Anëtarët e komitetit të auditimit nuk kishin pavarësi të plotë për zhvillimin e aktivitetëve.



Kryetari duhet të sigurohet se çështjet e dala nga fusha e qeverisjes së përgjithshme duhet të adresohen me një përgjegjësi dhe kujdes të shtuar. Me tutje, komiteti i auditimit duhet të rishikohet për të ëmeruar anëtarë të rinjë të cilët kanë pavarësi të plotë funksionale (shih çështjet 16 - 17).

Përgjigja e Kryetarit të Komunës

Kryetari është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e pasqyrat financiare vjetore. Ne kemi analizuar veprimtarinë e komunës se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Komunës së Mitrovicës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se:

- Komuna kishte buxhetuar dhe ekzekutuar pagesa gabimisht nga kodi i investimeve kapitale, në vlerë totale prej 177,570€¹, të cilat i përkasin kategorisë mallra dhe shërbime. Po ashtu në katër pagesa tjera, dy² prej tyre, në vlerë 4,440€ ishin ekzekutuar nga kodi i investimeve, të cilat i përkasin mallrave; ndërsa, dy³ pagesa tjera në vlerë 18,996€ janë ekzekutuar nga kodi i mallrave dhe shërbimeve, ndërsa i takonin kategorisë së subvencioneve;
- Komuna ka arritur të identifikoj pasurinë komunale për pronat në 27 zona rurale (fshatra) por jo edhe ti vlerësoj, ndërsa pronat për zonën urbane, nuk ka arritur t'i identifikoj. Si pasojë komuna nuk ka arritur të bëjë regjistrimin e plotë të pasurisë (tokat dhe objektet); dhe
- Raporti i avokatit të komunës nuk ishte i plotë dhe i saktë, 16 padi⁴ gjyqësore nuk ishin përfshirë në raportin e avokatit gjegjësisht as nuk ishin shpalosur në PFV. Këto padi gjyqësore nuk kishin vlerë. Ndërsa për gjashtë⁵ padi tjera, raporti i avokatit të komunës nuk ishte përditësuar. Duke mos përditësuar raportin, detyrimet kontingjente ishin nënvlerësuar për 17,456€. Për më tutje, nëse paditë gjyqësore vendosen në favor të paditësve, komuna pritet të ketë pasoja të rënda financiare.

Dobësitë e prezantuara tregojnë se komuna kishte pasaktësi në: klasifikimin e shpenzimeve, në regjistrat e pasurive, si dhe pasaktësi në prezantimin e detyrimeve kontingjente. Këtë e ka shkaktuar mungesa e kontrolleve në menaxhimin dhe raportimin e tyre.

Opinionin jonë nuk është modifikuar për këtë çështje.

Çështjet kyçe të auditimit

Si çështje kyçe të auditimit përmendim faktin se komuna, ka prezantuar gjendjen e llogarive të arkëtueshme, mirëpo nuk kishte shpalosje të duhura, që mund të konsideroheshin për nevoja të planifikimeve buxhetore të burimeve vetjake. Llogaritë e akumuluar përfshijnë edhe borxhet e bartura prej më shumë se pesë vitesh dhe mundësia e inkasimit është minimale.

Veprimi i shlyerjes së llogarive të arkëtueshme për taksat e ushtrimit të veprimtarisë së bizneseve për 1,587,196€ (nga 3,270,000€ në 1,682,804€) nuk është bërë përmes procedurave zyrtare apo nga ndonjë vendim nga Kuvendi Komunal ose Kryetari, si dhe nuk është shpalosur në pasqyrat financiare. Shlyerja ishte si pasojë e largimit të bizneseve që kanë të bëjnë me: largimin e bizneseve

¹Mbështetje për menaxhimin te mbeturinave" në vlerë 10,000€; "Ndërtimi dhe mirëmbajtja e varrezave dhe lapidarëve" në vlerë 9,967€; "Ndërtimi dhe mirëmbajtja e parqeve në hapësirat publike "në vlerë 12,000€; Mirëmbajtja e sipërfaqeve të gjelbëruara" në vlerë 43,238€; "Rrënimi i objekteve pa leje" në vlerë 38,500€; "Kryerje Emergjente Vllahi" në vlerë 22,865€; "Shenjzimi i rrugëve " në vlerë 20,000€; si dhe Ndërtimi i rrugëve në Stan -Trg" në vlerë 21,000€.

²Dru për ngrohjen e objektit arsimor fillor dhe të mesëm"1,240€ dhe 3,200€".

³"Shërbime të ndryshme shëndetësore të Caritas Kosova" 10,000€ dhe 8,996€".

⁴ Paditë gjyqësore janë siguruar nga të dhënat e Ministrisë së Drejtësisë.

⁵ Për katër padi procesi kishte përfunduar mirëpo ende ekzistonin në raporte me vlerë totale 8,050€ në një raste vlera financiare e padisë ishte nënvlerësuar në vlerë 25,394€ dhe një nuk ishte regjistruar fare, në vlerë 112€.

në komunën e Mitrovicës veriore, largimin e disa biznese që kanë fituar me vendime gjyqësore dhe për shkak të përdorimit të një softueri të vjetër i cili ka përlogaritur edhe bizneset pasive, e disa nga të cilat nuk ekzistojnë fare. Mos shpalojja e tyre në PFV mund të shkaktojë keq interpretime rreth humbjes potenciale.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV

Kryetari i Komunës së Mitrovicës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalojjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Komuna kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK); dhe
- Kërkesat tjera për raportime buxhetore, siç janë raportet tremujore duke i përfshirë këtu edhe pasqyrat nëntëmujore me kohë, dhe planin e prokurimit.

Në kontekst të PFV-ve, çështjet në lidhje me kornizën raportuese, nuk ishin adresuar me rastin e përgatitjes së PFV-ve të dorëzuara në muajin janar 2018.

- Tek raporti i ekzekutimit të buxhetit, shënimi 12, në kolonën e realizimit janë prezentuar grantet e përcaktuara të donatorëve si shpenzim jo si e hyrë e pranuar, ky gabim është reflektuar edhe tek shpalosjet e ndarjeve fillestare dhe finale të buxhetit, neni 14.6.

Po ashtu tek shpalosjet e pasqyrave financiare kishte gabime si në vijim:

- Llogaritë e arkëtueshme ishin nënvlerësuar në total në vlerë 26,601€⁶; dhe
- Numri i të punësuarave me marrëveshje për shërbime të veçanta nuk ishte prezentuar saktë. Në PFV ishin prezentuar 39 punëtorë, mirëpo të punësuar gjatë vitit ishin 32 punëtorë.

Gjatë kohës së auditimit komuna ka vërejtur mos shpalosjen e drejtë të çështjeve të lartë shënuara në PFV-të dhe ka bërë korrigjimet e nevojshme, përveç pjesës së shpalosjeve të llogarive të arkëtueshme për qiranë e mbivlerësuar për 2,102€.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në MF, mund të konsiderohet e saktë në të gjitha aspektet materiale.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

⁶ Tatimin në pronë ishin mbivlerësuar në vlerë prej 52,458€; pagesat për mbeturinat për ekonomi familjare ishin nënvlerësuar në vlerë prej 81,161€; qiraja ishte mbivlerësuar në vlerë prej 2,102€.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Për çështjet e sipër përmendura jepen rekomandimet si në vijim:

Rekomandimi 1 Kryetari, duhet të sigurojë se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet e theksuara në opinionin e auditimit dhe çështjet kyçe⁷. Veprime specifike duhet të ndërmerren për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për t'i eliminuar dobësitë e paraqitura.

Më tutje, Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV-ve 2018, i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

⁷ Keq klasifikimi i shpenzimeve, shpalosje jo e saktë e vlerës së pasurive dhe detyrimeve kontingente në PFV.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë lidhur me MFK-në, pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në komunë. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore, pasuritë si dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm.

Në kontekstin e sistemit financiar, kontrollet janë të vendosura, megjithatë, kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë planifikimi i buxhetit, planifikimi dhe menaxhimi i të hyrave, menaxhimi i burimeve njerëzore, llogarive të arkëtueshme, obligimeve të papaguara si dhe menaxhimi i pasurisë.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, shpenzimet e fondeve si dhe të hyrat e arkëtuara sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti Final ⁸ | 2017 Realizimi | 2016 Realizimi | 2015 Realizimi |
|---|-------------------|----------------------------|-------------------|-------------------|-------------------|
| Burimet e Fondeve: | 16,684,897 | 17,546,947 | 16,682,266 | 16,285,762 | 17,367,291 |
| Granti i Qeverisë -Buxheti | 14,247,965 | 14,591,682 | 14,471,605 | 13,980,967 | 15,773,053 |
| Të bartura nga viti paraprak ⁹ - | - | 344,361 | 328,678 | 291,289 | 255,570 |
| Të hyrat vetjake ¹⁰ | 2,436,932 | 2,436,932 | 1,759,351 | 1,755,799 | 1,230,437 |
| Donacionet e brendshme | - | 126,525 | 78,665 | 175,152 | 68,547 |
| Donacionet e jashtme | - | 47,447 | 43,967 | 82,555 | 39,684 |

⁸ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave.

⁹ Të hyrat vetjake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

¹⁰ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 862,050€. Kjo rritje është rezultat i donacioneve vendore dhe të jashtme, të hyrave të bartura nga viti paraprak, si dhe rritjes së aplikuar me vendimet e Qeverisë.

Në vitin 2017, komuna ka shpenzuar 95% të buxhetit final, me një rënie prej 1% krahasuar me vitin 2016.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

| Përshkrimi | Buxheti Fillestar | Buxheti Final | 2017 Realizimi | 2016 Realizimi | 2015 Realizimi |
|---|-------------------|-------------------|-------------------|-------------------|-------------------|
| Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike: | 16,684,897 | 17,546,947 | 16,682,266 | 16,285,762 | 17,367,291 |
| Pagat dhe Mëditjet | 11,410,884 | 11,429,077 | 11,338,652 | 11,485,848 | 11,262,513 |
| Mallrat dhe Shërbimet | 1,305,856 | 1,312,930 | 1,201,215 | 1,337,968 | 1,427,375 |
| Shërbimet komunale | 465,000 | 483,000 | 474,854 | 354,108 | 446,348 |
| Subvencionet dhe Transferet | 545,043 | 576,661 | 537,369 | 589,308 | 625,418 |
| Investimet Kapitale | 2,958,114 | 3,745,279 | 3,130,176 | 2,518,530 | 3,605,637 |

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Rritja e buxhetit për paga dhe mëditje për 18,193€, reflektohet nga të hyrat e bartura 13,348€ dhe donacionet e jashtme në vlerë 17,428€, ndërsa në emër të kursimeve buxhetore, kishte zvogëlim të buxhetit për 12,583€;
- Te mallrat dhe shërbimet kishte rritje për 7,074€, rritja e buxhetit përfshinte të hyrat e bartura në vlerë 6,035€ dhe nga donacionet në vlerë 1,039€. Kurse, buxheti për komunalitet ishte rritur për 18,000€ nga të hyrat e bartura;
- Te subvencionet dhe transferet kishte rritje për 31,618€, rritja e buxhetit përfshinte të hyrat e bartura në vlerë 1,001€ dhe nga donacionet e brendshme - participimet e qytetarëve në projektet për subvencionimin e fermerëve në vlerë 30,617€; dhe
- Te kategoria e investimeve kapitale kishte rritje në vlerë totale 787,165€, respektivisht me rishikim të buxhetit kishte rritje te investimet kapitale për projektin “Renovimi i shkollës Musa Hoti” në vlerë 356,300€ (Vendimi i Qeverisë). Kishte rritje edhe nga të hyrat e bartura në vlerë 305,977€ dhe nga donacionet e jashtme dhe të brendshme në vlerë 124,888€.

Pavarësisht rritjes së buxhetit për projekte kapitale, niveli i realizimit të investimet kapitale ishte 84% nga shuma e buxhetit final. Ndërsa te kategoritë tjera niveli i ekzekutimit të buxhetit kishte trend të lartë (mbi 90%).

Çështja 2 – Realizimi i buxhetit

E gjetura Edhe pse buxheti në tërësi është realizuar në masën 95%, në kontest të performancës situata tregon se planifikimi dhe shpenzimi ishte mjaft sfidues. Në fund të vitit është shfaqur nevoja për disa përshtatje buxhetore, duke shfrytëzuar mjetet e mbetura nëpër drejtori, me qëllim të realizimit të pagesave, përkatësisht shlyerjen e obligimeve. Për një përshtatje të tillë kishin ndikuar edhe pagesat direkte të ekzekutuara nga thesari dhe pagesat përmes vendimeve gjyqësore.

Nevojat e shumta për përshtatje, janë tregues që përgatitja fillestare e buxhetit nuk është bërë si duhet. Mos planifikimi i mirëfilltë dhe përshtatjet e tilla, kishin shkaktuar klasifikim jo adekuat të kategorive ekonomike (nënkapitulli 2.1).

Rreziku Planifikimi fillestar jo i duhur dhe mos kryerja e obligimeve me kohë rrisin rrezikun që objektivat e përcaktuara të komunës mos të arrihen. Po ashtu, klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve në kode ekonomike ndikon në paraqitjen jo të drejtë të tyre në PFV.

Rekomandimi 2 Kryetari, duhet të sigurojë që gjatë përgatitjes së kërkesave buxhetore t'i paraprijë një analizë e mirëfilltë të gjithë faktorëve që kanë ndikim në realizimin e buxhetit. Ndërsa, planifikimi dhe buxheti i projekteve të caktuara duhet të bëhet bazuar në planin kontabël të aprovuar nga Thesari.

3.2 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga komuna në 2017 ishin në vlerë 1,951,350€. Ato kanë të bëjnë me: të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja taksat administrative, etj. Gjithashtu, komuna kishte edhe të hyra indirekte të mbledhura nga dënimet e policisë dhe gjobat në vlerë 116,111€.

Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)

| Përshkrimi | Buxheti fillestar | Buxheti Final | 2017 Pranimet | 2016 Pranimet | 2015 Pranimet |
|------------------|-------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|
| Të hyrat vetjake | 2,436,932 | 2,436,932 | 1,951,350 | 1,995,219 | 1,517,742 |
| Totali | 2,436,932 | 2,436,932 | 1,951,350 | 1,995,219 | 1,517,742 |

Për vitin 2017, komuna, ka inkasuar 80% të te hyrave të planifikuara. Planifikimi i të hyrave nga tatimi në pronë kishte diferenca të ndjeshme krahasuar me realizimin. Komuna, për vitin 2017 ka planifikuar 607,728€, kishte faturuar 846,625€, ndërsa kishte inkasuar vetëm 261,640€. Këto mospërputhshmëri flasin për një planifikim jo real të komunës në këtë fushë.

Çështja 3 – Menaxhimi jo i duhur i të hyrave

E gjetura Viti 2017, është viti i parë që komuna ka filluar të arkëtojë të hyrat nga pagesat e mbeturinave për ekonomitë familjare dhe bizneset.

Procesi i menaxhimit të mbeturinave komunale i rregulluar me “Rregulloren nr.03/2016 për menaxhimin e mbeturinave”, nuk korrespondon me marrëveshjen për shërbime primare të menaxhimit të mbeturinave në mes të Komunës së Mitrovicës dhe KRM “UNITETI” SHA, e cila mbështetet në kontratën kornizë të vitit 2015 -2018. Sipas rregullores deponimi i mjeteve duhet të bëhet për çdo ditë¹¹, ndërsa sipas marrëveshjes në mes të Komunës dhe KRM Uniteti, ishte cekur që deponimi i mjeteve të bëhet çdo tri ditë nga inkasantët e KRM-së Uniteti.

Nga testimet tona kemi vërejtur se mbledhja/deponimi i mjeteve nga inkasantët, deponoheshin në bankën e komunës pas 3-4 ditëve, të cilat arrinin vlerën deri 4,500€, në kundërshtim me kërkesat e rregullës financiare 03/2010 për të hyrat dhe rregullores për mbeturina.

Komuna, nuk ka arritur të menaxhoj një sistem adekuat për menaxhimin e të hyrave nga mbeturinat, si pasoj e bazës jo adekuate të rregullave të brendshme dhe kontrolleve të brendshme.

Rreziku Mos korrespondenca e rregulloreve mes veti, mund të krijojë mundësi të keqinterpretimeve. Mbajtja e parave të gatshme dhe mos deponimi i tyre me kohë në llogari bankare, rritë rrezikun për keqpërdorimin e tyre.

Rekomandimi 3 Kryetari, duhet të sigurojë një sistem të përshtatshëm të regjistrimit, për të mbështetur mbledhjen dhe menaxhimin e të hyrave. Procesi i menaxhimit të të hyrave nga mbeturinat komunale duhet të rishqyrtohet, në mënyrë që të respektohen ligjet/rregulloret në fuqi.

¹¹ Rregulla 03/2010 për të hyrat kërkon që deponimi i mjeteve të bëhet për çdo ditë.

Çështja 4 - Mangësi në menaxhimin e pronave publike

- E gjetura** Nga testimi i listave të shfrytëzuesve të pronës publike (dhënien e banesave për kuadro), kemi vërejtur se në 12 raste, kontratat nuk janë valide në aspektin e periudhës kohore (ishin skaduar). Megjithatë, pronat shfrytëzohen ende pa ndonjë vendim zyrtar apo ripërtëritje të kontratës. Në mungesë të ripërtëritjes së kontratave komuna nuk i faturon këta shfrytëzues.
- Mungesa e kontrolleve dhe neglizhenca e komunës në këtë drejtim, ka ngritur dobësitë e përmendura.
- Rreziku** Mungesa e kontrolleve adekuate dhe mos veprimi me kohë nga komuna lidhur me shfrytëzimin e pronës publike rritë rrezikun që këto prona të keqpërdoren, dhe mjetet e parapara për shfrytëzimin e pronave publike të mos inkasohen.
- Rekomandimi 4** Kryetari, duhet të ndërmarr masat që sa më parë t'i pajisë qiramarrësit me kontrata në mënyrë që të kenë bazë ligjore të shfrytëzimit të te hyrave nga pronat komunale.

Çështja 5 - Mos verifikimi i pronave

- E gjetura** Për verifikimin e 1/3 së pronave, nuk kishte ndonjë raport të përgjithshëm për të dokumentuar se është arritur të bëhet verifikimi i pronave sipas ligjit nr.03/L204 dhe udhëzimeve administrative në fuqi.
- Komuna, kishte në dispozicion raportet vetëm për regjistrimet e reja dhe modifikimet, mirëpo jo edhe për ato ekzistuese.
- Rreziku** Mangësitë në dokumentacionin e kërkuar për verifikimin e pronave për qëllime të tatimit në pronë, rrezikon që komuna të mos ketë informata të mjaftueshme nëse të njëjtit kanë paguar të gjitha taksat ndaj asaj prone, e që mund të reflektohet edhe tek qytetarët.
- Rekomandimi 5** Kryetari, duhet të sigurojë se verifikimi i pronave komunale duhet të bëhet siç parasheh ligji, në mënyrë që në bazën e të dhënave të integrohen të gjitha ndryshimet eventuale tek pronat, të vlefshme për bazën e tatueshme.

3.3 Pagat dhe shtesat

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave. Kontrollat që operojnë në nivel lokal nga komuna kanë të bëjnë me: a) kontrolli i pagesave çdo muaj duke i nënshkruar listën e pagave, b) verifikimin e ndryshimeve të mundshme që mund të paraqiten përmes formularëve, si dhe c) rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimet me Thesarin.

Çështja 6 - Marrëveshjet kontraktuale dhe angazhimi i stafit në afat të caktuar

- E gjetura** Komuna, kishte angazhuar 32 punëtorë me marrëveshje për shërbime të veçanta. Komuna për këta të punësuar nuk kishte aplikuar procedurë të thjeshtësuar të rekrutimit ashtu siç parashihet me aktet e përcaktuara ligjore. Për me tepër në tre¹² raste të angazhuarit me marrëveshje për shërbime të veçanta ishin për pozita të rregullta dhe nuk kishin të bënin me punë specifike.
- Rreziku** Mbulimi i pozitave të rëndësishme me marrëveshje të përkohshme rezulton me performancë dhe monitorim të dobët të stafit dhe rritë pasigurinë nëse në pozitat e tilla është angazhuar stafi adekuat. Mungesë e konkurrencës së mirëfilltë, cilësia e shërbimeve të ofruara mund të jetë e nivelit të dobët dhe objektivat e organizatës të mos arrihen.
- Rekomandimi 6** Kryetari, duhet të sigurojë një plan të arsyeshëm për punët që ndërlidhen me shërbimet me marrëveshje të veçanta. Po ashtu, nevojat shtesë për punëtorë me pozita të rregullta, t'i trajtoj me organet përkatëse dhe të gjendet zgjidhja e pranuar, të parashikohen me rastin e planifikimeve buxhetore. Po ashtu, në rast të punësuarve me marrëveshje dhe shërbime të veçanta të aplikojë procedurë të thjeshtësuar të rekrutimit ashtu siç parashihet me aktet e përcaktuara ligjore.

¹² "Zyrtarë për buxhet dhe financa" dhe dy pozita "Asistente Administrative"

3.4 Menaxhimi i personelit

Menaxhimi i personelit bëhet në bazë të rregullores së brendshme me nr.01/2017 për organizimin kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të administratës komunale.

Çështja 7 - Mos aplikimi i procedurave të brendshme për avancim në pozitë

- E gjetura** Drejtoria e arsimit nuk kishte aplikuar procedura të brendshme për avancim në pozitë, për pozitën shef i sektorit në administratë dhe financë, siç parashihet me rregullore¹³.
- Rreziku** Mos respektimi i kërkesat ligjore, procedurale për avancim, është anashkalim rregullores dhe dhënies së mundësive të barabarta për konkurrim dhe trajtim të njëjtte.
- Rekomandimi 7** Kryetari, duhet të sigurohet se po respektohen procedurat, gjatë avancimit në karrierë të punësuarve, për t'i dhënë mundësi të barabarta për konkurrim të gjithëve kandidatëve potencial. Procedurat e tilla mundësojnë përzgjedhje më meritore.

3.5 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2017 ishte 1,795,930€ (përfshirë shërbimet komunale). Prej tyre ishin shpenzuar 1,676,068€. Ato kanë të bëjnë me furnizime me material harxhues, shërbime, mirëmbajtje dhe shërbime komunale.

Çështja 8 - Kontrata jashtë planit të prokurimit

- E gjetura** Ndonëse në planin e prokurimit nuk ishte e paraparë aktiviteti: "Furnizim me material shpenzues për nevoja të QKMF-së në Mitrovicë" në vlerë 8,785€, megjithatë, kontrata është nënshkruar. Planifikimi joadekuat ishte shkaktar i lidhjes së kontratës jashtë planit të prokurimit.
- Rreziku** Lidhja e kontratave jashtë planit të prokurimit, rrezikon realizimin e kontratave që janë planifikuar dhe ndryshimin në prioritet, apo edhe hyrjen në obligime pa mbështetje buxhetore.
- Rekomandimi 8** Kryetari, duhet të sigurojë se plani i prokurimit është hartuar pas një analize të hollësishme të të gjitha njësive kërkuese dhe ka përfshirë sipas prioritetëve të gjitha projektet, për të cilat janë siguruar fondet e duhura buxhetore.

¹³ Rregullore nr. 21/2012 për avancim në karrierë të nëpunësve civilë, neni 5.

Çështja 9 - Pranimi jo i rregullt i furnizimeve

- E gjetura** Pranimi i furnizimeve me medikamente mjekësore në vlerë 10,175€, ishte bërë vetëm nga depoisti, pa formuar ndonjë komision përkatës siç kërkohet me rregulloren nr.01/2013 për pranimin e furnizimeve ku parashihet formimi i komisionit. Mos zbatimi i rregullores reflekton se kontrollet e brendshme nuk janë adekuate.
- Rreziku** Mungesa e pranimin të furnizimeve pa komision, rritë rrezikun që të pranohen furnizime të cilësisë jo të mirë dhe në kundërshtim me kushtet e kontraktuara.
- Rekomandimi 9** Kryetari, duhet të bëjë një rishikim të brendshëm për të përcaktuar vendimet lidhur me formimin e komisionit përkatës për të konfirmuar se furnizimet janë pranuar sipas cilësisë dhe sasisë së paraparë me kontratë.

Çështja 10 - Mangësi administrative në zhvillimin e procedurave të prokurimit

- E gjetura** Te kontrata “Furnizimi i shkollave me inventar dhe kabinete” në vlerë 7,021€, raporti i vlerësimit nuk ishte i nënshkruar nga zyrtari i prokurimit.
- Me tutje, për kontratën “Furnizimi, mirëmbajtja dhe montimi i pajisjeve mjekësore” në vlerë prej 44,964€, komisioni për vlerësimin e ofertave ishte formuar prej tre anëtarëve, por njëri prej tyre nuk kishte nënshkruar deklaratën nën betim. Po ashtu vendimi i komisionit për hapjen e tenderit nuk është i nënshkruar nga zyrtari i prokurimit.
- Rreziku** Mungesa e konfirmimit formal për procesin e hapjes dhe vlerësimit tregon se kontrollet e brendshme nuk janë mjaftë funksionale dhe si pasojë mund të ekzistojë rreziku për devijime procedurale në proceset e prokurimit si dhe vlerësim jo të drejtë të ofertave.
- Rekomandimi 10** Kryetari, duhet të sigurojë se procesi i hapjes dhe vlerësimit të tenderit është përcjellë me monitorim të duhur nga ana e komisionit dhe zyrtarit të prokurimit duke konfirmuar formalisht tërë procesin konform kërkesave të Ligjit për Prokurimin Publik.

3.6 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 576,661€. Prej tyre në 2017 ishin shpenzuar 537,369€. Shpenzimet kryesisht kishin të bëjnë me shpenzimet e varrimit, bursa për student, mbështetje të fermerëve, si dhe personave fizik si përfitues individual në gjendje të vështirë social-ekonomike.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.7 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 3,745,279€. Prej tyre në 2017 ishin shpenzuar 3,130,175€, që kanë të bëjnë me investime në ndërtimin e infrastrukturës rrugore dhe objekteve të ndryshme kapitale. Me ligjin e buxhetit janë planifikuar të realizohen 55 projekte kapitale, prej të cilave ishin realizuar 42 projekte, përmes procedurave të prokurimit. Për 10 të tjera nuk kishte nevojë të zhvillohen procedura të prokurimit meqë ishin të lidhura në vitet paraprake si kontrata kornizë, ndërsa tri projekte tjera nuk ishin realizuar.

Rrjedhimisht katër projekte kapitale nuk ishin paraparë në planin e prokurimit, për tri projekte ishte marrë aprovimi nga AQP-ja dhe një projekt kapital ishte i paparashikuar për "Ndërtimin e kulmit të djegur në shkollën "Musa Hoti" (rast emergjent).

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë (përveç çështjeve të identifikuara në nënkapitullin 3.8).

3.8 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet Kapitale

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale:

Çështja 11 - Mos nënshkrimi i planit të menaxhimit të kontratave

| | |
|-----------------------|--|
| E gjetura | Në katër ¹⁴ raste të testuara, ishin caktuar menaxherët e kontratave, dhe ishte përgatitur plani për menaxhimin e kontratës, mirëpo plani nuk ishte nënshkruar nga autoriteti kontraktues e në disa raste as nga menaxheri i kontratës. |
| Rreziku | Mungesa e konfirmimit formal krijon rrezikun për një menaxhimi jo adekuat të kontratave dhe mund të ndikojë që ato të mos përfundojnë sipas kushteve të kontraktuara. |
| Rekomandimi 11 | Kryetari, duhet të sigurojë se për të gjitha kontratat të emërohen menaxherët, të cilët duhet të përgatisin dhe nënshkruajnë planin për menaxhimin e kontratës konform kërkesave të Ligjit për Prokurimin Publik. |

¹⁴ Furnizim i shkollave me inventar dhe kabinete" në vlerë 7,021€ "Furnizim me material shpenzues për QKMF në Mitrovicë" në vlerë prej 8,785€; "Sigurimi i automjeteve të komunës së Mitrovicës dhe institucioneve komunale" në vlerë prej 9,618€; dhe "Rregullimi i njejtve sanitare në shkollën fillore dhe të mesme (Eqrem Qabej)" në vlerë 4,810€.

3.9 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Menaxhimi i pasurisë është një pjesë e rëndësishme e menaxhimit financiar dhe kontrollit në sektorin publik. Një menaxhim i mirë i pasurive kërkon që komuna të ketë një pamje të plotësisë së pasurive, procedura të kontrollit dhe menaxhimit të tyre dhe të azhurnojë vazhdimisht ndryshimet në regjistrat e saj. Udhëzuesi kryesor në këtë fushë është rregullorja nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore. Vlera e pasurive kapitale në PFV në fund të vitit 2017 është 27,426,412€.

Çështja 12 - Dobësitë në sistemin e-pasuria

E gjetura Komuna nuk ka arritur që t'i regjistrojë të gjitha pasuritë nën 1,000€, përfshirë asetet, materialet shpenzuese, etj. Në nëntë¹⁵ raste pasuritë nën 1,000€ në vlerë 5,139€ nuk ishin regjistruar në sistemin e-pasuria, por vetëm në një listë të brendshme të komunës (regjistër në Excel).

Rreziku Dobësitë në sistemin e-pasuria rrisin rrezikun e gabimeve gjatë evidentimit të pasurisë si dhe përlogaritjes manuale të zhvlerësimit. Kjo po ashtu mund të rezultojë me mos përmbushje të kërkesave të kontabilitetit dhe raportimit financiar të pasurisë.

Rekomandimi 12 Kryetari, duhet të sigurojë që të marrë veprime të nevojshme për ta aplikuar sistemin e menaxhimit të pasurisë (e-pasuria), në mënyrë që të ketë një menaxhimin dhe raportim të pasurisë në përputhje me kërkesat e rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare. Me pas të sigurohen trajnimet e duhura për stafin e komunës të cilët do të përcaktohen përgjegjës për zbatimin e këtij sistemi.

¹⁵ Katër kompjuterë në vlerë 3,350€, Termo-3, në vlerë 340€, Inventar (mobilje) në vlerë 498, Monitor në vlerë 156€, UPS në vlerë 245€, Laptop-i7 në vlerë 550€.

3.10 Trajtimi i parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj

Paratë e imta janë fond i vogël i parave që mbahet në përkujdesjen dhe kontrollin e organizatës buxhetore, departamentit ose njësisive më të vogla buxhetore varësisht nga ndarjet buxhetore, dhe që shfrytëzohet për të mbuluar shpenzimet me vlerë të vogël (deri 100€).

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.11 Të arkëtueshmet

Komuna ka vendosur një sistem të kontrollit të brendshëm që mbikëqyrë procesin e llogarive të arkëtueshme duke e menaxhuar përmes drejtorive përkatëse. Megjithatë, edhe më tutje sistemi i kontrollit duhet të forcohet, për të parandaluar rritjen e të arkëtueshme nga viti në vit dhe vlera e tyre të ulët në një shkallë të pranueshme.

Llogaritë e arkëtueshme në fund të vitit 2017 ishin në vlerë prej 7,497,745€, në këtë shumë janë të përfshira tatimi në pronë, tarifata komunale, taksat dhe tarifata e urbanizmit, qiraja, pagesat për mbeturina për ekonomitë familjare, kontrollimi sistematik i punëtorëve-AKP Trepça, si dhe pagesat për lëshimin e certifikatave të vdekjes.

Nga tatimi në pronë i faturuar për 2017 (duke përjashtuar arkëtueshmet e viteve paraprake, kamatën dhe ndëshkimet) në vlerë prej 846,625€ ishte mbledhur vetëm 261,640€ apo 31%.

Çështja 13 - Menaxhim jo efikas i llogarive të arkëtueshme

E gjetura Komuna, nuk ka të vendosur procedura të brendshme për raportim dhe regjistrimin e llogarive të arkëtueshme dhe aplikimin e procedurave për inkasim.

Rritja e të arkëtueshmeve nga viti në vit vazhdon të mbetet sfidë për komunën. Mungesa e një analize për të identifikuar/nxjerrë shkaktarët e mos mbledhjes se tyre ka rezultuar me një inkasim të dobët.

Komuna, kishte dhënë prona komunale në shfrytëzim me qira për periudha afatgjata. Në katër raste kemi vërejtur se shfrytëzuesit nuk kishin paguar asnjëherë ndaj komunës qiranë mujore. Obligimi i tre qiramarrësve, arrin vlerën totale prej 81,888€ dhe janë nga që nga viti 2011, ndërsa një obligim tjetër në vlerën 5,058€ është që nga viti 2016. Në kontratat e nënshkruara specifikohet se në rast se obligimet nuk paguhen shëkëputet kontrata. Megjithatë, komuna nuk kishte marrë veprime konkrete për arkëtimin e këtyre të hyrave, përveç, disa vërejtjeve me shkrim për mos pagesë, të bëra në vitin 2018.

Rreziku Mungesa e veprimeve të mjaftueshme apo mangësitë në procesin për inkasimin e të arkëtueshmeve, mund t'i dekurajojnë tatimpaguesit tjerë që t'i paguajnë obligimet e tyre me kohë. Për më tutje, mos realizimi i të hyrave të planifikuara, rritë rrezikun e dështimit të projekteve të planifikuara nga burimet vetanake. Vjetërsia e të arkëtueshmeve e vështirëson mbledhjen e tyre.

Rekomandimi 13 Kryetari, duhet të sigurojë se ka forcuar kontrollet në menaxhimin e të arkëtueshmeve, rritjen e efikasitetit si dhe forcimin e kontrolleve në menaxhimin dhe arkëtimin e tyre. Në këtë aspekt, të analizohen shkaktarët e rritjes së të arkëtueshmeve në mënyrë që të ndërmerren veprimet ligjore për mbledhjen e tyre.

3.12 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2017 ishte 1,425,216€. Këto obligime janë bartur për t'u paguar në vitin 2018. Krahasuar me vitin e kaluar (1,072,653€), obligimet kanë shënuar rritje prej 352,563€.

Ndërsa, Detyrimet Kontingjente, në fund të vitit 2017 ishin 3,452,768€, krahasuar me vitin e kaluar detyrimet (1,073,000€) kanë shënuar rritje të konsiderueshme. Kjo rritje ishte për shkak se komuna në këtë vite ka arritur t'i regjistrojë disa detyrime kontingjente që kanë mbetur pa u përfshirë në të dhënat e vitit të kaluar.

Ne nuk kemi identifikuar ndonjë parregullsi në raportimin e obligimeve në MF. Ato janë raportuar në pajtueshmëri me kërkesat e rregullores për raportimin e obligimeve të papaguara.

Çështja 14 - Menaxhimi jo efektiv i obligimeve të papaguara

E gjetura Krahasuar me vitin e kaluar obligimet kanë shënuar rritje prej 352,563€. Vlera më e lartë e tyre ishte nga investimet kapitale. Si rrjedhojë e menaxhimit jo të mirë, kishte raste kur pagesat për faturat e papaguara ishin ekzekutuar direkt nga thesari sipas nenit 39.2 të LMFP në vlerë 212,588€ dhe sipas vendimeve të Gjykatës Themelore në vlerë 528,706€. Kjo kishte ndodhur si pasoj e mos pagesës me kohë të faturave/obligimeve.

Në 17 raste tjera faturat/obligimet nuk ishin paguar brenda afatit ligjor prej 30 ditëve.

Rreziku Dështimet e pagesave ndaj furnitorëve në afatet ligjore dhe rritja enorme e obligimeve gjatë vitit 2017, rritë rrezikun që planet e shpenzimeve aktuale të mos realizohen për shkak që komuna duhet t'i shlyej obligimet e vitit paraprak. Kjo, gjithashtu, mund të rezultojë edhe me padi gjyqësore apo pagesa direkte nga thesari.

Rekomandimi 14 Kryetari, duhet të konsideroj që me rastin e planifikimit të buxhetit t'i trajtoj obligimet e mbetura me Ministrinë e Financave dhe të vendosë prioritetet buxhetore në kryerjen e tyre, si dhe të caktoj politika konkrete për parandalimin e hyrjeve në obligime të reja. Po ashtu t'i kryej obligimet me kohë sipas afatit të paraparë ligjor.

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2016 të komunës ka rezultuar në 22 rekomandime kryesore. Komuna, kishte përgatitur një Plan Veprimi me vonesë ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2016, shtatë rekomandime janë zbatuar, pesë ishin në proces ndërsa dhjetë nuk janë zbatuar ende. Ndërkaq, në vitin 2015 ishin dhënë 25 rekomandime, prej të cilave tetë ishin zbatuar, tetë janë në procese të zbatimit, ndërsa nëntë nuk ishin trajtuar ende nga ana e menaxhmentit.

Kryetari i Komunës ka shqyrtuar raportin e auditimit për vitin 2016 në Asamblenë Komunale, mirëpo nuk ka prezantuar progresin lidhur me zbatimin e planit të veprimit për rekomandimet e auditimit para se PFV-të të dorëzohen në MF-së.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni Shtojcën II.

Çështja 15 - Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga viti paraprak dhe viti i mëhershëm

E gjetura Komuna edhe pse ka hartuar një plan veprimi (me vonesë), megjithatë, kjo nuk është mbështetur me një proces konfirmues ku zbatimi i rekomandimeve monitorohet formalisht. Kjo pasqyron mungesën e fokusit nga menaxhmenti për të siguruar që rekomandimet zbatohen me kohë dhe pengesat për veprim pritet të identifikohen dhe adresohen.

Si pasojë, disa prej rekomandimeve si: keq klasifikimi i shpenzimeve, çështja e plotësisë së regjistrave të pasurisë, mungesa e regjistrit të rreziqeve, skadimi i kontratave të shfrytëzuesëve të pronave komunale, menaxhimi jo i duhur i obligimeve, si dhe rritja e llogarive të arkëtueshme janë të gjetura të përsëritura në raportet e auditimit në vitet e fundit.

Rreziku Mos zbatimi i plotë i rekomandimeve rritë rrezikun e pranisë së vazhdueshme të mangësive të njëjta dhe mund të rezultojë në mos efikasitet të vazhdueshëm të kontrolleve, vështirësi në menaxhimin e sfidave në përmbushjen e objektivave apo edhe në humbje financiare.

Rekomandimi 15 Kryetari, duhet të sigurojë që plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të përpilohet me kohë, të monitorohet në vazhdimësi dhe të raportohet në baza të rregullta tremujore në lidhje me progresin e arritur në këtë drejtim. Rekomandimet të cilat nuk zbatohen sipas afateve, të rishikohen në një afat të shkurtër nga kryetari, si dhe të ndërmerren veprime pro-aktive ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit.

5 Qeverisja e mirë

Hyrje

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA-së me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK-së nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i pyetësorëve të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen MF-së.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Në qeverisjen lidhur me aktivitetet operacionale dhe financiare në komunë ende mbesin fusha ku nevojiten veprime të rëndësishme. Vëmendje e shtuar e menaxhmentit nevojitet në proceset për adresimin e rekomandimeve të auditimit dhe proceseve të menaxhimit të rrezikut. Përgjigja efektive ndaj rekomandimeve të auditimit nuk janë të vendosura ndërsa struktura e komitetit të auditimit nuk ishte adekuate.

Komuna, kishte plotësuar pyetësorin e vet-vlerësimit (pyetësori ishte mbështetur me dëshmi), mirëpo procedurat e duhura për menaxhim të rrezikut ende nuk janë vendosur.

Strategjia gjithëpërfshirëse e zhvillimit socio-ekonomik lokal 2014-2017 konsiderohet se është e vendosur nga ana e komunës si dhe aprovimet e disa planeve tjera në sektorë të ndryshëm, të aprovuara nga Kuvendi Komunal: Plani i veprimit për Transparencë në komunë; Plani Lokal Antikorrupcion; Plani i integritetit për vitin 2017-2019; Plani i punës së Kuvendit Komunal për vitin 2017; si dhe Plani komunal i veprimit për të zhvendosurit për zgjidhje të qëndrueshme.

5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Komuna ka të themeluar Njësinë e Auditimit të Brendshëm (NjAB), e cila operon me tre anëtarë të stafit - Drejtori i NjAB-së dhe dy auditor. Përveç Planit strategjik, NjAB kishte hartuar edhe Planin vjetor të punës ku ishin përfshirë gjashtë auditime për vitin 2017.

NjAB, realizuar të gjitha auditimet e planifikuara, gjithsej gjashtë auditime. Raportet e auditimit kanë trajtuar fusha të ndryshme dhe janë përfunduar me kohë. Po ashtu, kishte përgatitë raporte tre mujore, të cilat i ka dërguar edhe në Njësinë Qendrore Harmonizuese.

Çështja 16 - Struktura e komitetit të auditimit jo adekuate

E gjetura Sipas udhëzimit administrativ nr.11.2010 për themelimin dhe funksionin e komitetit të auditimit në subjektin e sektorit publik, anëtarët e komitetit të auditimit duhen të jenë të pavarur. Në rastin konkret, ky kusht nuk përmbushet, pasi që anëtarët e komitetit të auditimit janë në përbërje nga: auditori i brendshëm, zyrtari kryesor financiar dhe dy anëtarë tjerë nga drejtoria e financave. Auditori i brendshëm mund vetëm të marrë pjesë në seancat e komitetit të auditimit, por jo edhe të jetë pjesë e tij, ndërsa zyrtarët tjerë u nënshtrohen vetë auditimit të brendshëm nuk mund të jenë të pavarur.

Për më tutje, ishte bërë plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga NjAB për periudhën nën auditim. Megjithatë, ky plan i veprimit, nuk ishte bërë nga menaxhmenti, por nga komiteti i auditimit.

Rreziku Komiteti i auditimit me strukturën aktuale nuk ka pavarësinë e duhur dhe si i tillë nuk mund të ofrojë opinion të paanshëm rreth çështjeve ku mund të jenë të involvuar departamentet, pjesë e të cilave janë vetë anëtarët e komitetit të auditimit.

Në anën tjetër, mos gatishmëria e menaxhmentit për hartimin e planeve të veprimit zvogëlon efikasitetin dhe ndikimin e shërbimeve të auditimit të brendshëm në përmirësimin e qeverisjes së përgjithshme.

Rekomandimi 16 Kryetari, duhet të rishikoj emërimin e anëtarëve të komitetit të auditimit dhe të sigurohet se përzgjedhja e tyre është adekuate sipas kërkesave të rregullores përkatëse, duke mënjanuar zyrtarët që mund të jenë subjekt i auditimit të brendshëm. Gjithashtu, duhet të rishikojë veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me hartimin e planeve të veprimit si dhe zbatimin e rekomandimeve të auditimit nga NjAB.

5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranimit i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, ne kemi vërejtur se masat e aplikuara ende kërkojnë përmirësim.

Çështja 17 - Dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut

Rreziku Rishikimi ynë i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin financiar kryesor të komunës ka nxjerr në pah se angazhimet e përgjithshme të kontrolleve kërkojnë përmirësim, në menaxhimin e shpenzimeve duke i klasifikuar në kode adekuate, trajtimin e obligimeve të papaguara dhe pagesën e tyre me kohë, si dhe veprime konkrete për arkëtimin e llogarive të arkëtueshme.

Komuna, nuk ka politika të shkruara dhe procedura për menaxhimin e rreziqeve, në veçanti rrezikut të mashtrimit dhe parregullsive. Nuk ekziston ndonjë regjistër i rreziqeve i hartuar sipas kërkesave të MFK-së dhe raport për menaxhimin e tyre.

Rreziku Kërkesat e dobëta të llogaridhënies dhe raportimi financiar, reduktojnë efektivitetin e menaxhimit financiar brenda komunës, duke rezultuar me dobësi në procesin buxhetor si dhe në reduktimin e mundësisë që menaxhmenti të reagojë ndaj sfidave financiare me kohë.

Rekomandimi 17 Kryetari, duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme brenda një periudhe të arsyeshme kohore. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, organizata duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontrolle kërcënimet e ekspozuara.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe

gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

të përfshihet menjëherë pas opinionit;

të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;

të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe

të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake

| Komponenta e Auditimit | Rekomandimet e bartura nga viti 2015 | Të zbatuara gjatë vitit 2017 | Në proces të zbatimit gjatë 2017 | Të pa zbatuara |
|------------------------|--|------------------------------|--|----------------|
| 2. Pasqyrat Financiare | Kryetari duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PVF 2016 i adreson të gjitha çështjet e ngritura përfshirë rreziqet domethënëse të identifikuar. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e PVF-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime. | | Në proces, komuna kishte formuar komision për identifikimin e pronave. Komisioni kishte bërë identifikimin e pronave vetëm në zonat rurale, ndërsa në zonën urbane nuk kishte arritur ta bëjë identifikimin, për më tutje vlerësimi i pronave të identifikuar ende nuk ishte bërë. Po ashtu, edhe në këtë vit kishte keq-klasifikime të shpenzimeve. | |
| 2. Qeverisja | Kryetari duhet të sigurojë një planifikim të qartë të prokurimit, ku do të specifikohen veçmas shërbimet, mallrat dhe punët e planifikuara të cilat i nënshtrohen ligjit të prokurimit. Për të kryer një planifikim të mirë të prokurimit zyrtar të prokurimit do t'i nevojitet bashkëpunimi i ngushtë me departamentin e buxhetit dhe departamentet tjera. Më tutje, të siguroj që me vendim të caktoj komisionin për pranimin e mallrave në pajtim me rregulloren Nr.02/2013, si dhe raporti i pranimin të mallit të jetë në pajtim me rregullën financiare Nr. 01/2013 MF-shpenzimi i parave publike. | | Proces, ishte bere një planifikim i detajuar i prokurimit. Mirëpo, ende kishte mangësi gjatë pranimin të mallrave. | |

| | | | | |
|--|--|--|---|----------------------|
| 2.3 Rekomandim et e vitit paraprak | Kryetari duhet të forcoj masat e kontrollit dhe të përgjegjësisë ndaj personave të ngarkuar për adresimin e plotë të rekomandimeve që veprimet e parashikuara me plan veprimi të zbatohen, në veçanti në fushat e identifikuar me shkallë të lartë rreziku dhe brenda afateve të përcaktuara. | | | Nuk janë marrë masa |
| 2.4 Lista Kontrolluese e vetëvlerësimit | Kryetari duhet të sigurojë se është zbatuar një rishikim për plotësimin e listës kontrolluese të vetëvlerësimit dhe që është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë aktive. Një proces rishikimi duhet të aplikohet nga auditimi i brendshëm për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës. | | Komuna, kishte plotësuar pyetësorin e vetëvlerësimit (pyetësori ishte mbështetur me dëshmi). Mirëpo, procedurat e duhura për menaxhim të rrezikut ende nuk janë vendosur. | |
| 2.5 Rishikimet specifike të qeverisjes | Kryetari duhet të sigurojë që pasi të jetë hartuar regjistri i rreziqeve, është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut tek një drejtor përkatës i cili në koordinim me udhëheqësit e njësive do të menaxhojë këtë proces dhe do të raportojë në baza të rregullta mbi rreziqet. | | | Nuk janë marrë masa. |
| 2.5.2 Raportimi Menaxherial | Kryetari duhet të sigurojë se cilësia e kontrolleve dhe mbikëqyrjes buxhetore duhet të rishikohet në mënyrë kritike dhe sistematike për të siguruar se janë vendosur kontrolle të përshtatshme në fushat ku janë identifikuar dobësitë. | | Në proces, disa fusha janë marrë masa si p.sh: komisionet për identifikimin e pasurive; në krahasim me vitin e kaluar te procedurat e prokurimit kishte një menaxhim më të mirë; për llogaritë e arkëtueshme ishin marrë disa iniciativa për ta prezantuar vlerën e saktë, mirëpo ende ka nevojë që kontrollet të forcohen. | |

| | | | | |
|--------------------------------------|--|--|--|----------------------|
| 2.6 Sistemi i auditimit të brendshëm | Kryetari duhet të ndërmarr veprime konkrete dhe të vazhdueshme, të reagoj me kohë në gjetjet dhe rekomandimet e dhëna nga auditimi i brendshëm, ndërsa komiteti i auditimit të bëjë një plan pune ku do t'i specifikoj agjendat e punës dhe temat që do t'i trajtoj gjatë vitit. Në procesverbalet e takimeve, të nxjerrë konkluzione të qarta për menaxhmentin lidhur me çështjet e auditimeve të brendshëm. | | | Nuk janë marrë masa. |
| 3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli | Kryetari duhet të sigurohet që me rastin e planifikimeve buxhetore, të bëhet një vlerësim gjithëpërfshirës i burimeve potenciale i të hyrave, dhe të përcaktoj opsione praktike për përmirësimin e ekzekutimit për vitin 2016. Një monitorim sistematik i trendeve buxhetore do të rriste mundësitë për një performancë më efektive. | | Në proces, planifikimi për taksat e ushtrimit të veprimtarisë të bizneseve ishte bërë, por ende kishte hapësirë për një planifikim më të mirë. | |
| 3.4 Prokurimi | Kryetari duhet t'i shqyrtoj arsyet pse rastet e mësipërme në procesin e prokurimit kanë ndodhur, dhe të forcoj kontrollet e prokurimit në të gjitha fazat e procesit. Një qasje e përmirësuar nevojitet sidomos në planifikimin fillestar të nevojave, dhe në shmangien maksimale të procedurave për kontrata me vlera të vogla dhe minimale, përveç rasteve kur kjo vlerësohet e domosdoshme. Gjithashtu, duhet të siguroj se para inicimit të procedurave të prokurimit të nënshkruhet deklarata e disponueshmërisë së mjeteve, të emëroj menaxherët e kontratave dhe të bëjë aprovimin e komisioneve vlerësuese, ashtu siç parashohin rregulloret e prokurimit. | | Proces, ende duhet të shtohen kontrollet tek procedurat e prokurimit edhe pse disa raste janë çështje administrative. | |

| | | | | |
|---|--|----|--|--|
| | Kryetari duhet të siguroj respektimin e çmimeve kontraktuale, si dhe kontrollet e çertifikimit të pagesave dukshëm të forcohen dhe të parandalojnë të gjitha pagesat e tilla. Të siguroj mbikëqyrje në detaje për funksionimin e kontrolleve në mënyrë që të evitohen këto parregullsi, dhe të gjej shkakun se pse ka ndodhur këto parregullësi. | | Proces, kishte pagesa gjegjësisht vlera të konsiderueshme të bëra me vendime gjyqësore dhe përmes pagesave direkte të ekzekutuara nga thesari, për shkak të mos pagesave me kohë dhe mos zotimi i mjeteve me kohë për obligimet ndajë operatorëve ekonomikë. | |
| 3.5 Shpenzimet jo përmes prokurimit | Kryetari duhet të sigurojë se për të gjitha aktivitetet që parashihen procedura të prokurimit, ato të zbatohen në mënyrë strikte, siç parashihet me Ligjin e Prokurimit Publik. | Po | | |
| | Kryetari duhet të sigurojë se nuk do të bëjë pagesa para se të konfirmohet se punimet apo shërbimet janë kryer. Pagesat duhet të jenë të dokumentuara me fatura dhe raporte të konfirmuara për pranimin e punëve/shërbimeve. Aspekti i mbikëqyrjes dhe raportimit të detyrimeve që dalin nga këto marrëveshje, duhet të jetë subjekt i shqyrtimeve të rregullta nga menaxhmenti i komunës. Për të eliminuar rrezikun për dështimin e këtyre marrëveshjeve, ne do të sugjerim që praktikat e tilla të pagesave të ndërpriten. | Po | | |
| 3.5.2 Kompenzimet (pagat dhe mëditjet) | Kryetari duhet të siguroj që arsyet e gabimeve në ekzekutimin e pagave duhet të rishikohen, si dhe të shtojë kontrollet tek menaxhimi i personelit në mënyrë që rastet e tilla të mos përsëriten. Pagesat e kryera në mënyrë të pa drejtë, duhet të t'i kthehen buxhetit të komunës. | Po | | |

| | | | | |
|--|--|----|--|----------------------|
| | Kryetari duhet që para fillimit të vitit shkollor të analizoj nevojat për numrin e stafit të domosdoshëm në sektorin e arsimit, dhe në rast të barrierave ligjore, çështjen ta diskutoj edhe me Ministrinë e linjës dhe Qeverinë, në mënyrë që të siguroj se stafi i angazhuar nuk do të mbetet jashtë listës së pagave. | | | Nuk janë marr masa. |
| | Një shqyrtim sistematik i Dosjeve të Personelit duhet të ndërmerret, për të siguruar se i tërë dokumentacioni i nevojshëm është përfshirë brenda një periudhe të specifikuar kohore, si dhe të gjitha pagesat janë të mbështetura. Vlerësimi i punëtorëve duhet të kryhet të paktën një herë në fund të çdo viti shkollor. | Po | | |
| | Kryetari duhet të shtoj kontrollet tek shëndetësia në mënyrë që pagesat e shpenzimeve të udhëtimit të bëhen nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, duke i dokumentuar ato sipas rregulloreve të thesarit. | Po | | |
| 3.5.3 Subvencionet dhe Transferet | Kryetari duhet të siguroj që të vendosen kontrolle me rastin e pagesave, në mënyrë që të gjithë artikujt të paguhen sipas çmimeve të kontraktuara. | Po | | |
| | Kryetari duhet të siguroj që kriteret e përcaktuara me Rregulloren për subvencione zbatohen në tërësi. Në të kundërtën, subvencionet nuk duhet të jepen. | Po | | |
| 3.6 Të hyrat | Kryetari duhet t'i rishikojë kontratat dhe marrëveshjet për qiratë, si dhe procedurat ekzistuese në mbledhjen e taksave dhe të merr masa për inkasimin e të gjitha borxheve të mbetura nga qiratë. Nëse kjo nuk është e mundur, atëherë duhet të merren pronat e dhëna, dhe përmes ankandit publik t'u ofrohen shfrytëzuesve tjerë potencial që kryejnë pagesat me kohë të qirave. | | | Nuk janë marrë masa. |

| | | | | |
|-----------------------------------|--|----|---|----------------------|
| | Kryetari duhet të sigurojë se bëhet identifikimi i pengesave në inkasimin e tatimit në pronë dhe të krijoj një plan konkret me të gjitha masat përcjellëse për të maksimizuar nivelet e inkasimit nga tatimi në pronë. | | | Nuk janë marrë masa. |
| | Kryetari të sigurojë që Departamenti i Financave të ndërtoj një bazë të dhënash (program) dhe të sistemoj të gjithë informacionin e duhur për bizneset që aktivisht operojnë brenda territorit të komunës. Gjithashtu, duhet të aplikohen masa efektive që taksat e biznesit të inkasohen sipas periudhave të vitit, duke mos injoruar edhe borxhet e mëhershme. | | Proces, këtë vit komuna kishte marrë iniciativë për largimin e bizneseve pasive ose atyre që nuk operojnë fare. | |
| | Kryetari duhet të rishikoj rastin e këtyre pagesave, dhe të gjithë kandidatëve që kanë paguar më tepër se shumat e përcaktuara me U/A dhe rregullore, t'u bëhet rimbursimi. | Po | | |
| 3.7 Pasuritë dhe detyrimet | Kryetari duhet të siguroj që sa më parë komisioni të bëj vlerësimin e drejtë dhe të plotë të të gjithë pasurive që janë në pronësi të komunës, dhe të monitoroj rezultatet e vlerësimit. Po ashtu, për të pasur një evidencë të saktë të stoqeve, të gjitha hyrjet/daljet e pasurive të luajtshme me vlera nën 1,000€ të bëhen përmes sistemit e-pasuria. | | | Nuk janë marrë masa. |
| 3.7.2 Trajtimi i të arkëtueshmeve | Kryetari duhet të inicioj një proces rivlerësimi (shqyrtimi), ku të gjitha llogaritë do të analizohen në kuptimin e vjetërsisë, vlefshmërinë e borxheve individuale të shumave domethënëse, mundësive reale për inkasim dhe ushtrimin e masave administrative (nëse ka nevojë). | | | Nuk janë marrë masa. |

| | | | | |
|--|--|-------------|--|----------------------|
| 3.7.3 Trajtimi i borxheve | Për t'iu shmangur hapjes së kontesteve gjyqësore dhe ekzekutimit të pagesave direkte nga Thesari, kryetari duhet të trajtoj me kujdes këtë situatë, dhe të merr masat e duhura që të planifikoj buxhetin për kryerjen e borxheve ndaj furnitorëve dhe mësimdhënësve si dhe të parandaloj hyrjen në obligime të reja pa zotimin paraprak të fondeve. | | | Nuk janë marrë masa. |
| Komponenta e auditimit | Rekomandimet e dhëna në vitin 2016 | Të zbatuara | Në proces të zbatimit | Të pa zbatuara |
| 1.2 Pasqyrat Financiare Vjetore | Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjeve, të ndërmerr veprime në adresimin e shkaqeve të mos arritjes së regjistrimit dhe vlerësimit e të plotë të pasurisë, dhe të sigurohet se komuna do të pranoj kundërvlerën për avancet e paguara sipas Marrëveshjes së Bashkëfinancimit për projektin KSV/018. | | Komuna, kishte formuar komision për identifikimin e pronave. Komisioni ende nuk kishte arritur t'i identifikoj të gjitha pronat. Identifikimi i pronave ishte bërë vetëm në zonat rurale, ndërsa në zonën urbane nuk kishte arritur ta bëjë identifikimin. | |
| 2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak | Kryetari duhet të forcoj masat e kontrollit dhe të përgjegjësisë ndaj personave të ngarkuar për adresimin e plotë të rekomandimeve që veprimet e parashikuara me plan veprimi të zbatohen, dhe nga ta të pranoj raporte të rregullta për progresin e rekomandimeve kundrejt planit të veprimit. | | | Nuk janë marrë masa. |
| 2.2 Pyetësi i vet-vlerësimit | Kryetari duhet të siguroj se është zbatuar një rishikim për plotësimin e listës së rreziqeve, forcimin e çështjeve tjera menaxhuese dhe që është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë aktive. | | | Nuk janë marrë masa |

| | | | | |
|---|---|----|---|---------------------|
| 2.3.2 Raportimi Menaxherial dhe llogaridhënia | Kryetari duhet të siguroj se cilësia e kontrolleve dhe mbikëqyrjes buxhetore të rishikohet në mënyrë sistematike për të siguruar se janë vendosur kontrolle të përshtatshme në fushat ku janë identifikuar dobësitë. | | Proces, edhe pse janë ndërmarrë masa, kontrollet e brendshme ende duhet të përmirësohen, kishte mangësi në menaxhimin e shpenzimeve duke i klasifikuar në kode jo adekuate; trajtimin e obligimeve të papaguara dhe pagesën e tyre me kohë, si dhe veprime konkrete për arkëtimin e llogarive të arkëtueshme. | |
| 2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm | Kryetari duhet të ndërmarr veprime konkrete për përpilimin e planit të veprimit për rekomandimet e AB dhe të kërkoj nga bartësit përgjegjës të cilëve u janë adresuar rekomandimet që edhe formalisht të raportojnë mbi zbatimin e atyre rekomandimeve. | | | Nuk janë marrë masa |
| 3.1.1 Të hyra | Kryetari duhet të sigurohet që të bëhet një plan për inkasimin e të hyrave nga taksat e biznesit duke faturuar çdo biznes në baza të rregullta mujore, të sigurohet që lista të jetë e përditësuar me bizneset aktive që ushtrojnë veprimtari dhe të aplikohen masa konkrete për zvogëlimin e të arkëtueshmeve të akumuluar ndë vite. | | Të hyrat janë planifikuar. Komuna është përpjekur që ta ketë një listë të saktë për taksat e biznesit, megjithatë nuk ishte bërë përmes procedurave zyrtare. | |
| | Kryetari i komunës duhet të sigurohet që rregulloret aktuale janë në zbatim në mënyrë që të bëhen ngarkesat e tarifave drejtë duke evituar mundësinë e gabimeve, njëkohësisht të rishikoj rastet e tilla dhe të konsideroj trajtimin e gabimeve të kaluara. | Po | | |

| | | | | |
|--------------------------|--|----|--|---------------------|
| | Kryetari duhet të sigurohet se afatet e caktuara kohore janë duke u zbatuar sipas ligjit të ndërtimit. Aplikuesit duhet të pajisen me leje të ndërtimit ose refuzimit brenda afateve të parapara me ligj. Gjithashtu, kontrole të shtuara duhet të vendosen për të siguruar që asnjë leje e ndërtimit nuk do të lëshohet nëse paraprakisht nuk janë kryer obligimet ndaj komunës. | Po | | |
| | Kryetari duhet të ndërmarr masat që sa më parë t'i pajisë qiramarrësit me kontrata në mënyrë që të kenë bazë ligjore të shfrytëzimit të pronave komunale dhe të merr masa konkrete për inkasimin e të gjitha borxheve të mbetura nga qiratë. Po ashtu, të ngarkohen me taksë të gjithë shfrytëzuesit e pronave komunale. Në të kundërtën, komuna duhet të ndërmarr hapa që pronat e njëjta t'u jep në shfrytëzim qiramarrësve të përgjegjshëm. | | | Nuk janë marrë masa |
| 3.1.2 Pagat dhe mëditjet | Kryetari i Komunës duhet t'i rishikoj nevojat reale për angazhim të punëtorëve me kontrata për shërbime të veçanta. Kjo çështje duhet të trajtohet në mënyrë serioze dhe nevojat për staf shtesë për pozitat e rregullta të parashikohen me rastin e planifikimeve buxhetore. | | | Nuk janë marrë masa |
| | Kryetari i komunës duhet të ndërmerr veprime për sa i përket vendimeve që merren dhe të jenë në përputhje me dispozitat ligjore, si dhe të vlerësojnë nevojat dhe pagesat për punë jashtë orari, duke e respektuar nenin 13 dhe nenin 40.2 të Ligjit për administrimin e pushtetit lokal dhe dispozitat e tjera ligjore relevante. | Po | | |

| | | | | |
|--------------------------------------|---|----|--|----------------------|
| Mallrat dhe shërbimet | Kryetari duhet të siguroj që furnizimet do të bëhen vetëm me artikujt e kontraktuar, dhe me raport të pranimit nga menaxheri i kontratës, kurse certifikuesi duhet të shtoj kontrollet me rastin e verifikimeve të dokumentacionit dhe të siguroj se janë përmbushë të gjitha kushte ligjore që pagesa të certifikohet. | | Proces, kishte përmirësime nga viti i kaluar, në përgjithësi pagesat ishin certifikuar sipas rregullave në përjashtim të mos zbatimit të rekomandimit nga viti i kaluar, për të cilën komuna nuk kishte arrite ta zbatojë rekomandimin pasi që kontrata ishte kornizë. | |
| | Kryetari duhet ta shqyrtoj pse kërkesat ligjore nuk janë përmbushur në këto raste dhe të shtoj kontrollet për të siguruar se situata të tilla nuk do të përsëriten dhe janë respektuar të gjitha kërkesat e legjislacionit në fuqi. | | | Nuk janë marrë masa. |
| | Kryetari duhet të shtoj kontrollet gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit, t'i përmbahet planifikimeve dhe të siguroj fondet para hyrjes në obligime. Gjithashtu, të siguroj se gjatë vlerësimit të tenderëve, Komisioni t'iu përmbahet kërkesave të dosjes së tenderit dhe vlerësimi të kryhet dhe të pasohet me raporte formale të nënshkuara nga komisioni. | | Proces, ende duhet të shtohen kontrollet tek procedurat e prokurimit edhe pse disa raste janë çështje administrative. | |
| 3.1.4 Subvencionet dhe transferet | Kryetari të konsideroj mundësinë e plotësisimit/ndryshimit të rregullores ekzistuese në mënyrë që të përcaktohen kritere shtesë lidhur me limitet për dhënie e subvencioneve, në mënyrë që mundësia për përfitimin e subvencioneve të jetë e arsyeshme. | Po | | |
| 3.1.5 Investimet kapitale | Kryetari duhet të siguroj që planifikimet për shpenzime të bëhen konform kodeve ekonomike adekuate të ndara për kategori. | | | Nuk janë marrë masa |

| | | | | |
|--------------|--|----|--|----------------------|
| | Kryetari duhet të sigurohet që kontratat kornizë përveç çmimeve për njësi, të kenë edhe vlerën totale të përafërt të projektit në mënyrë që të evitohen parregullsitë e shfrytëzimit të mjeteve. Po ashtu, secila kontratë të ketë menaxherin e kontratës, planin për menaxhimin e kontratës dhe komisionet vlerësuese të caktohen nga Zyrtari Kryesor Administrativ. | Po | | |
| | Kryetari duhet të shtoj kontrollet në shfrytëzimin e parasë publike, dhe të siguroj që asnjë faturë të mos pranohet në mënyrë të parregullt, pa pasur kontratë të nënshkruar dhe në pajtim me rregullat financiare. | Po | | |
| 3.2 Pasuritë | Kryetari duhet të sigurohet që të kryhet identifikimi dhe vlerësimi i pasurisë së komunës dhe të ketë regjistra të plotë të pasurisë. Komisioni i inventarizimit duhet të krahasoj gjendjen kontabël me gjendjen faktike dhe të verifikoj ekzistencën fizike të pasurive dhe stoqeve. Aty ku vërehen mospërputhje, komisioni përmes raportit përfundimtar duhet t'i raportoj menaxhmentit. Rezultatet e regjistrimit duhet të azhurnohen edhe në regjistrat kontabël. Gjithashtu, të regjistrohen të gjitha pasuritë e komunës nën 1000€ në sistemin e-pasuria, duke përfshirë edhe Shëndetësinë dhe Arsimin | | | Nuk janë marrë masa. |

| | | | | |
|---------------------------|---|----|--|---------------------|
| | Kryetari duhet të merr masa të menjëhershme që përmes raporteve të zyrtarëve përgjegjës të vlerësoj në mënyrë gjithëpërfshirëse shkallën e progresit në ndërtimit të këtyre shtëpive, arsyeshmërinë e shpenzimeve, tejkalimet, nevojat për fonde shtesë dhe pajtueshmërinë e shpenzimeve me rregulloret financiare. Shtëpitë e banimit duhet të regjistrohen si investim në vijim në regjistrat e pasurisë së komunës deri në përfundimin e projektit dhe pranimin teknik. Pas përfundimit të projektit, duhet të bëhet transferi i pasurisë tek përfituesit. | Po | | |
| 3.2.2 Të arkëtueshmet | Kryetari duhet ta analizoj efektivitetin e mekanizmave në dispozicion për mbledhjen e borxheve, si dhe të propozoj masa dhe procedura plotësuese për të reduktuar sa më shumë gjendjen e këtyre llogarive. Po ashtu, duhet të rishikohen listat e faljes së borxheve dhe të veprohet konform rregullave të përcaktuara. | | | Nuk janë marrë masa |
| 3.3 Obligimet e papaguara | Kryetari duhet të analizoj në baza mujore ecuritë buxhetore dhe të balancoj nevojat me fondet disponibile dhe të parandaloj të gjitha veprimet që shpiejnë në krijimin e obligimeve pa sigurimin paraprak të fondeve. | | | Nuk janë marrë masa |

Shtojca III: Letër konfirmimi



REPUBLIKA E KOSOVËS

Republika Kosova - Republic of Kosoves

Komuna e Mitrovicës Jugore

Opština Juzna Mitrovica - Municipality of Mitrovica South



ZYRA E KRYETARIT

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2017 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Komunës së Mitrovicës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 .
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Agim Bahtiri

Kryetar i Komunës së Mitrovicës,

Data: 22.05.02018, Mitrovicë,